



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria -Vlada-Government*

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural  
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja  
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

# **STRATEGJIA PËR ZHVILLIMIN E PYLLTARISË**

## **2010 – 2020**

**Prishtinë 2009**

# **Strategjia për Zhvillimin e Pyltarisë**

**2010 – 2020**

Kjo Strategji është e hartuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural përmes një Grupi Punues ndërministror i caktuar për formulimin e politikave dhe të strategjive që do të qeverisin zhvillimin e ardhshëm të Sektorit Pyjor në Kosovë. Hartimi i suksesshëm i këtij dokumenti strategjik nuk do të ishte i mundur pa mbështetjen e plotë të anëtarëve të Grupit Punues, sikur edhe prej ndihmës dhe këshillave të marra nga pjesëmarrësit nëpër takime të ndryshme të punës, seminare si dhe nga palë të tjera të interesit.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural gjithashtu falënderon SIDA-në dhe FAO-në, të cilat, përmes projektit GCP/KOS/004/SWE kanë mbështetur Ministrinë gjatë procesit të hartimit të këtij dokumenti.

**Prishtinë, nëntor 2009**

## PËRMBAJTJA

<b>SHKURTESAT</b> .....	5
<b>HYRJE</b> .....	6
<b>1. ROLI I QEVERISË</b> .....	8
1.1 Objektivi i Përgjithshëm, përcaktimi i politikave dhe i drejtimeve .....	8
1.2 Përgjegjësitë e Qeverisë në zhvillimin e sektorit pyjor .....	9
1.3 Përcaktimet institucionale, instrumentet politike .....	11
1.4 Përshtatshmëria me strategjitë dhe planet nacionale dhe ato ndërkombëtare .....	12
<b>2. GJENDJA E SEKTORIT PYJOR</b> .....	14
2.1 Resurset pyjore .....	14
2.2 Vështirësitë e Sektorit Pyjor .....	15
<b>3. POLITIKAT PËR INTERVENIM NË FUSHAT ME PRIORITET</b> .....	17
3.1 Menaxhimi i pyjeve dhe silvikultura .....	17
3.2 Planifikimi pyjor dhe menaxhimi i informacioneve .....	19
3.3 Shfrytëzimi dhe transporti i drurit .....	22
3.4 Ndërtimi i kapaciteteve .....	23
3.5 Mbrojtja e mjediseve pyjore .....	24
3.6 Shfrytëzimi i drurit – zhvillimi i industrisë pyjore .....	25
3.7 Zhvillimi i sektorit privat .....	26
3.8 Produktet pyjore jodrusore .....	28
<b>4. KORNIZA PËR IMPLEMENTIMIN E STRATEGJISË</b> .....	30
4.1 Principet që duhet aplikuar .....	30
4.2 Projektet e kërkuara për ngritje të njohurive në fushat e pazhvilluara (Shtylla I) .....	30
4.3 Mbështetje për përmirësimin dhe ndryshimin e operacioneve (Shtylla II) .....	31
4.4 Mekanizmat për të mbështetur zbatimin e strategjisë (Shtylla III) .....	33
4.5 Përmbledhje e aktiviteteve për zbatimin e strategjisë .....	33
4.6 Rreziqet e përfshira, veprimet që mund të zvogëlojnë efektin .....	35

## Lista e tabelave

<b>Tabela 1. Fushat e përcaktuara për ndërhyrje</b> .....	17
<b>Tabela 2. Zbatimi i Strategjive</b> .....	34

## SHKURTESAT

<b>AK</b>	<b>Agjencioni Kadastral</b>
<b>AKP</b>	<b>Agjencioni Kosovar i Privatizimit</b>
<b>APK</b>	<b>Agjencioni i Pyjeve të Kosovës</b>
<b>BE</b>	<b>Bashkimi Evropian</b>
<b>DP</b>	<b>Departamenti i Pylltarisë</b>
<b>FAO</b>	<b>Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqim dhe Bujqësi</b>
<b>IHP</b>	<b>Instituti për Hulumtime Pyjore</b>
<b>MASHT</b>	<b>Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë</b>
<b>MBPZHR</b>	<b>Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural</b>
<b>MMPH</b>	<b>Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor</b>
<b>MEF</b>	<b>Ministria e Ekonomisë dhe Financave</b>
<b>MPMS</b>	<b>Ministria e Punës dhe Mirëqenjës Sociale</b>
<b>MTI</b>	<b>Ministria e Tregtisë dhe Industrisë</b>
<b>NSH</b>	<b>Ndërmarrjet Shoqërore</b>
<b>OJQ</b>	<b>Organizata Jo Qeveritare</b>
<b>PZHRB</b>	<b>Plani për Zhvillim Rural dhe Bujqësor</b>
<b>SIDA</b>	<b>Agjencioni Suedez për Zhvillim Ndërkombëtarë</b>

**HYRJE**

Kosova ka hyrë në procesin e harmonizimit të legjislacionit dhe të standardeve me ato të Bashkimit Evropian, përmes të cilit pritet që sektorë të ndryshëm që ndërtojnë ekonominë do të jenë të ristrukturuar dhe më modernë. Në këtë kontekst, një prej segmenteve të rëndësishme të programit të Qeverisë është zhvillimi i zonave rurale dhe zhdukja e varfërisë, çka do të thotë ofrim i mundësive më të mëdha lidhur me rritjen e të ardhurave për familjet e zonave rurale, ndërmarrjet e vogla dhe stabilitet të komunave.

Në këtë kontekst, funksionet ekonomike, sociale dhe ekologjike të pyjeve janë me rëndësi qenësore për zhvillimin e qëndrueshëm dhe për përmirësimin e kualitetit të jetës në Kosovë, posaçërisht në zonat rurale dhe ato malore. Duke u bazuar në këto funksione të dobishme të pyjeve, Kosova pyjet i rendit si pjesë të pasurisë kombëtare/trashëgimore. Ligji për Pyje konfirmon këtë qëndrim: “Pyjet e Kosovës janë resurse kombëtare. Ato duhen të menaxhohen në atë mënyrë që të ofrojnë një prodhimtari të qëndrueshme dhe në të njëjtën kohë të ruajnë larminë biologjike për të mirën e gjeneratave të tashme dhe atyre të ardhshme. Menaxhimi i pyjeve duhet të marrë parasysh edhe interesat e tjera për publikun e gjerë”. Ligji poashtu afirmon parimet e masave parandaluese, të konservimit të lloj-llojshmërisë biologjike, parimet e barazisë së gjeneratave si dhe nevojat për aplikimin e zhvillimit të qëndrueshëm ekologjik.

Pas përfundimit të luftës në Kosovë, vendi hyri në një periudhë të vështirë të tranzicionit, ku sistemi ekonomik dhe ai politik u rindërtua për t’iu përshtatur një ambienti plotësisht të ri. Kjo periudhë e tranzicionit u rëndua edhe më tepër me situatën komplekse politike, sociale dhe ekonomike gjë që afektojë në funksionet e të gjithë sektorëve, ku nuk është përjashtim as pylltaria. Praktikrat menaxhuese pyjore të pakontrolluara dhe të paqëndrueshme kanë rezultuar në stagnimin dhe shkatërrimin e resurseve pyjore.

Ndryshimet politike dhe ekonomike të radhitura sipas proceseve integruese evropiane, adresojnë prioritetet dhe fokusohen drejt menaxhimit dhe shfrytëzimit shumëqëllimor të pyjeve, duke integruar edhe aspekte shumë më të gjera, ku mbrojtjes së mjedisit dhe larmisë biologjike i është dhënë prioritet i lartë. Në të njëjtën kohë, Kosova është në proces të nënshkrimit të shumë marrëveshjeve ndërkombëtare, konventave për mbrojtje të mjedisit dhe të pyjeve, gjë e cila do të ketë një ndikim të madh për sektorin e pylltarisë.

Dokumente strategjike për sektorin pyjor në Kosovë janë Ligji për Pyjet, 2003, i ndryshuar në vitin 2004, një plan për sektorin pyjor i hartuar në vitin 2002 dhe një dokument i politikave pyjore i hartuar në versionin e parë të tij në vitin 2003.

Mjedisi i ri ekonomik, dhe gjendja në sektorin pyjor theksojnë nevojën urgjente për krijimin e sistemeve efikase për menaxhim shumëqëllimor të resurseve pyjore, si dhe zhvillimin e një industrie pyjore e cila është në harmoni me resurset ekzistuese pyjore. Si përgjigje për këtë nevojë, në maj të vitit 2008, Qeveria e Kosovës ka filluar procesin e hartimit të Politikave dhe Strategjisë Nacionale për Pyje. Procesi është i bazuar në principet e njohura për zhvillimin e politikave, përmes kontributeve të ekspertëve vendorë dhe atyre ndërkombëtarë, si dhe të palëve të tjera të interesuara. Politikat dhe strategjia e sugjeruar janë në përputhje me legjislacionin pyjor ekzistues dhe rregullojnë shtigjet për të gjitha vendimet e mëdha, të cilat kanë të bëjnë me pylltarinë për 10 vjetët e ardhshëm. Rezultatet e këtij procesi janë të prezantuara në këtë dokument nga një ekip ekspertësh.

## 1. ROLI I QEVERISË

### 1.1 Objektivi i Përgjithshëm, përcaktimi i politikave dhe i drejtimeve

Objektivi i përgjithshëm i Qeverisë së Republikës së Kosovës është që të ngritët kontributi i sektorit pyjor në ekonominë nacionale, nëpërmes shfrytëzimit të qëndrueshëm të resurseve pyjore, duke marrë parasysh gjithmonë rolin shumëfunktional të pyjeve. Në mënyrë që të ketë përputhje me objektivin e përgjithshëm, Qeveria do të mirëmbajë dhe do të zgjerojë zbatimin e aktiviteteve të sektorit përmes ofrimit të një kornize mbështetëse institucionale dhe rregullative, si dhe të sigurojë mekanizma të përhershëm financiarë për përmirësim të gjendjes së sektorit.

#### Qeveria e Kosovës

- a) njeh rëndësinë e resurseve pyjore si pjesë integrale e shoqërisë në aspektin ekonomik, kulturor dhe social;
- b) çmon kontributin e pylltarisë për ekonomi, krijimin e vendeve të punës, çështjeve sociale dhe kulturore, mbrojtje të mjedisit dhe të natyrës;
- c) nënvizon rëndësinë e mbrojtjes së pyjeve për mirëmbajtje stabile dhe të shëndoshë të ekosistemit;
- d) është e vetëdijshme për gjendjen e pakënaqshme të resurseve pyjore, e cila karakterizohet me shfrytëzim jo të qëndrueshëm, me një intensitet të ulët në menaxhimin e pyjeve, me mbrojtje të pamjaftueshme dhe shfrytëzim nën optimal të resurseve pyjore;
- e) vërteton se resurset pyjore nuk janë të shfrytëzuara në përputhje të plotë me potencialet e tyre për shkak të disponueshmërisë së kufizuar të teknologjisë dhe të personelit të trajnuar, dobësive në strukturat organizative dhe në zbatimin e legjislacionit, të cilat rregullojnë mbrojtjen e pyjeve dhe menaxhimin e resurseve pyjore;
- f) nënvizon se sektori privat pyjor është i karakterizuar me sipërfaqe të vogla pyjore (fragmentime), të cilat rezultojnë me produktivitet të ulët dhe shfrytëzim të pamjaftueshëm të tokave pyjore;
- g) adreson kërcënimet e tanishme ndaj menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve që rezultojnë nga kapaciteti i kufizuar për të investuar në menaxhimin e pyjeve, prerjet e paligjshme, zjarret pyjore, kërcënimin e biodiversitetit në pyjet produktive;
- h) vlerëson se ndërmarrjet e vjetra shoqërore nuk janë funksionale, kështu që ato duhet t'i nënshtrohen procesit të privatizimit;



- i) njeh faktin se industria e përpunimit të drurit e ka të pamundur që të marrë pjesë në mënyrë adekuate në zhvillimin e sektorit pyjor;
- j) çmon domethënien e rëndësisë së bashkëpunimit ndërkombëtarë për zhvillimin e sektorit pyjor;
- k) thekson nevojën për fuqizimin e dialogut politik ndërmjet sektorit pyjor dhe pjesëve të tjera të shoqërisë;
- l) përkujton se politikat pyjore si politika sektoriale janë një komponent e rëndësishme e politikave shtetërore për zhvillimin e qëndrueshëm të Kosovës, dhe të cilat do të sigurojnë një kornizë për një planifikim më detaj përbrenda sektorit pyjor;

Përcaktimi dhe miratimi i të gjitha këtyre politikave dhe drejtimeve zhvillimore është bazuar në parimet vijuese:

- a) Në lidhje dhe në përputhje me objektivat, ligjet, politikat dhe strategjitë zhvillimore kombëtare,
- b) Pjesëmarrje të të gjitha palëve të interesit;
- c) Mbështetje socio-ekonomike për sektorin pyjor;
- d) Ruajtje të trashëgimisë kulturore;
- e) Përputhshmëri me përkushtimet ndërkombëtare për pylltarinë;
- f) Aplikim të qasjes ndërsektoriale;
- g) Ngritje të vetëdijes së shoqërisë për rëndësinë e pyjeve;

## **1.2 Përgjegjësitë e Qeverisë në zhvillimin e sektorit pyjor**

Qeveria do të sigurojë që pyjet dhe tokat pyjore në Kosovë janë të menaxhuara në pajtueshmëri me principet për konsensusin global të menaxhimit dhe mbrojtjes dhe zhvillimit të qëndrueshëm të të gjitha llojeve të pyjeve. Kjo përfshin principet parandaluese, principet e barazisë ndërmjet gjeneratave, konservimin e larmisë biologjike dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekologjik. Në përputhje me objektivin e përgjithshëm, përcaktimet politike, përgjegjësitë e Qeverisë mund të përmbliken në këto funksione themelore, si në vijim:

### **Zhvillimi i një kornize mbështetëse institucionale dhe rregullative**

Përmes zhvillimit dhe fuqizimit të një kornize mbështetëse institucionale dhe rregullative, pavarësisht nga pronësia, aktivitetet e sektorit do të orientohen në drejtimin e dëshiruar. Elemente të rëndësishme këtu janë monitorimi i vazhdueshëm i resurseve pyjore për të siguruar një shfrytëzim të

qëndrueshëm të pyjeve, ofrim të resurseve adekuate për institucionet qeveritare përgjegjëse për pylltari si dhe freskimi i kornizës rregullative që do t'i reflektonte ndryshimet dhe trendët zhvillimore në shoqëri. Proceset e reformave duhet të jenë transparente dhe të lejojnë pjesëmarrjen e plotë të të gjitha palëve të interesit.

### **Administrimi dhe menaxhimi me tokat pyjore në pronësi të shtetit**

Duke promovuar sisteme moderne të menaxhimit dhe të mbikëqyrjes transparente, Qeveria do të ngritë në maksimum potencialin e përfitimit të shumanshëm nga shfrytëzimi i pyjeve dhe tokave pyjore publike. Në këtë pikëpamje, elemente të rëndësishme janë proceset e konsolidimit të tokave, të cilat lejojnë shfrytëzim më racional të tokave pyjore dhe pyjeve në të dy sektorët, atë privat dhe shtetërorë, si dhe promovimi i sistemeve dhe i mjeteve që lejojnë sektorin privat që të marrë përgjegjësitë për menaxhim të pjesëve të caktuara të tokave pyjore shtetërore.

### **Mbrojtja e vlerave mjedisore**

Kosova aspirojnë që të menaxhojë me pyje në pajtueshmëri me deklaratën e konsensusit global të menaxhimit, konservimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm të të gjitha llojeve të pyjeve. Kjo përfshin edhe parimet e parandalimit, biodiversitetit, barazisë së gjeneratave dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekologjik (Konferenca e KB-ve në Rio De Zhanjero 1992). Në praktikë, kjo do të thotë se të gjitha intervenimet menaxheriale, gjithmonë duhet të ekzekutohen me objektiv që të ketë ndikime dhe dëme sa më të vogla në florë, faunë dhe vlera të tjera të eko-sistemit pyjor.

Menaxhimi i zonave të mbrojtura do të kërkojë kujdes të posaçëm, dhe aty përmbushja e parimeve dhe obligimeve të sipërpërmendura kërkon një bashkëpunim më të ngushtë dhe më transparent ndërmjet ministrive të interesuara.

### **Bashkëpunimi ndërsektorial, kontaktet ndërkombëtare, financimi i aktiviteteve**

Pylltaria ngërthen në vete një numër të elementeve që kanë implikim në shumicën e palëve të interesit. Që të evitohen konfliktet dhe të lejohet shfrytëzimi optimal i tokave pyjore, vendimet e rëndësishme duhet të bazohen në konsensus. Qeveria është në dijeni për nevojat e krijimit dhe të mirëmbajtjes së rrjeteve të kontakteve ndërkombëtare, duke lejuar këmbimin e njohurive dhe të përvojave. Kjo, në veçanti, është e rëndësishme për fushat e përgjegjësisë në të cilat sektori pyjor me mjete të veta është i paaftë që të krijojë institucionet dhe resurset e domosdoshme.

Qeveria gjithashtu është e vetëdijshme për nevojat e mirëmbajtjes së kontakteve adekuate me donatorë dhe institucione tjera financiare të rëndësishme për zhvillimin e të dy sektorëve pyjorë, atij publik dhe privat.

## **Aspektet sociale**

Pylltaria dhe industria pyjore janë elemente të rëndësishme për ekonominë e Kosovës. Kjo posaçërisht vlen për zonat rurale, ku një numër i konsiderueshëm i popullatës siguron mjetet e jetesës nëpërmes operacioneve pyjore. Qeveria do të bëjë përpjekje që të mundësoj përfitime sociale nga operacionet pyjore, në të dy perspektivat atë afatshkurtër dhe afatgjatë. Menaxhimi i intensifikuar i pyjeve të reja do të sigurojë përfitime të menjëhershme në formën e krijimit të mundësive të punësimit dhe ngritjen e qasjes në vlerat drunore. Në perspektivat afatgjata krijimi i pyjeve të reja nëpërmes programit të pyllëzimeve do të mundësojë jo vetëm ngritjen e operacioneve në sektor, por do të ketë efekte pozitive edhe në mjedis.

## **Implementimi i politikave dhe strategjive**

Qeveria do të marrë përsipër përgjegjësinë e plotë për implementimin e politikave dhe të strategjive. Në përgjithësi, këto përgjegjësi do të përfshijnë planifikimin strategjik për udhëzimin e investimeve dhe veprimeve tjera zhvillimore, duke siguruar koordinim të duhur dhe bashkëpunim në mes institucioneve qeveritare, aktivitetet lidhur me çështjet e bashkëpunimit ndërkombëtarë, monitorim dhe vlerësim të zbatimit të projekteve dhe të aktiviteteve.

### **1.3 Përcaktimet institucionale, instrumentet politike**

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) është autoriteti më i lart përgjegjës për pylltari në Kosovë. Në nivelin qendror janë dy njësi kryesore përgjegjëse për pylltari – Departamenti i Pylltarisë (DP) dhe Agjencioni i Pyjeve të Kosovës (APK).

APK i ka katër drejtori qendrore (drejtoria për menaxhim me pyje, drejtoria për menaxhim me kulloza, kafshë të egra, gjueti dhe ekoturizëm, drejtoria për silvikulturë, hulumtim dhe prodhim fidanor dhe drejtoria e administratës së përgjithshme), gjashtë drejtori koordinuese rajonale që koordinojnë aktivitetet pyjore përmes 29 njësive komunale, ndërsa një prej detyrave kryesore të këtyre njësive është bashkëpunimi me qeveritë lokale (komunat). APK operon me një fidanishte që gjendet afër qytetit të Pejës. Aty kryesisht prodhohen fidanë të specieve halore dhe ofrohen materiale mbjellëse për 300 – 500 ha që mbillen në vit.

DP ka rolin e hartimit të politikave dhe të kornizës rregullative, sikur edhe të kontrollit/inspektimit të operacioneve pyjore të udhëhequra për zbatim të ligjit. Inspektorët e pylltarisë janë përgjegjës për kontrollimin e aktiviteteve në pyjet publike dhe ato private.

Struktura dhe mandatet e degëve qeveritare përgjegjëse për pylltari janë të influencuara prej faktorëve, siç janë madhësia e sektorit pyjor, disponueshmëria e resurseve kompetente humane, struktura e pronësisë, nevojat për ndryshim të politikave dhe nevojat për luftim të praktikave ilegale. APK-ja është administratore dhe menaxhere e tokave pyjore publike dhe gjithashtu është përgjegjëse për zbatim të ligjit në tokat pyjore publike dhe ato private. Në të ardhmen, dhe në pajtueshmëri me proceset e tjera legale dhe zhvillimore, Qeveria mund të konsiderojë mundësitë për lirim të APK-së nga detyrat, të cilat mund të jenë në kontradiktë me përgjegjësitë e saj për zbatim të legjislacionit pyjor.

#### **1.4 Përshtatshmëria me strategjitë dhe planet nacionale dhe ato ndërkombëtare**

Për t'iu shmangur konflikteve dhe kontradiktave të mundshme, politikat dhe strategjitë e përcaktuara duhet të jenë kompatible me dokumentet udhëzuese që kanë ndikim në sektorin pyjor. Në këtë aspekt, me rëndësi të veçantë është Plani për Zhvillimin Rural dhe të Bujqësisë në Kosovë (PZHRB) i azhurnuar për periudhën 2009 – 2013 dhe strategjitë e BE-s së bashku me planet e veprimit për zhvillimin e sektorit pyjor.

PZHRB përfshin pjesë që ofrojnë një kornizë për zhvillim e pylltarisë deri në vitin 2013. Elemente të rëndësishme të planit janë:

- Shfrytëzim i qëndrueshëm ekonomik, mjedisor dhe social i pyjeve, me theks të veçantë në pyllëzime të tokave bujqësore të braktisura dhe përmirësim të infrastrukturës pyjore. Kjo do të ndihmojë pyllëzimin dhe krijimin e sistemeve agro-pyjore, veçanërisht në zonat e Natura 2000. Kur të zbatohen këto aktivitete, do të mbrohen mjediset pyjore, do të rikthehen potencialet prodhuese pyjore, do të veprohet kundër prerjeve ilegale dhe do të ofrohet mbështetje për investime joproductive në nënsektorët pyjorë;
- Me faktin se një pjesë e madhe e pronarëve të pyjeve janë fermerë, pylltaria mund të shihet si një zgjidhje për zgjerimin e zhvillimit rural. Disa fermerë mund të shohin si një mundësi për të kaluar nga prodhimtaria bujqësore në atë pyjore, apo të plotësohet ajo;
- Rritja e pyllëzimeve nëpër toka të braktisura bujqësore është një aktivitet me rëndësi, si për reduktimin e varësisë bujqësore, ashtu edhe për përmirësimin e kushteve mjedisore në zonat rurale. Kjo do të ndikojë në mënyrë pozitive në llojlojshmërinë e peizazheve dhe stabilitet. Në perspektiven e gjerë ndërkombëtare, një modifikim i shfrytëzimit të tokës drejt rritjes së pjesës së tokës me më shumë bimë permanente do të kontribuojë pozitivisht në politikat e tanishme për ndryshime klimatike përmes sekuestrimit të karbonit dhe duke promovuar

menaxhimin e qëndrueshëm pyjor. Gjithashtu mund të ketë ndikim pozitiv edhe në biodiversitet.

Në vitin 2006, Bashkimi Evropian miratoj një Plan të Veprimit për Pyje (2007- 2013) duke ofruar një kornizë për veprimtaritë e ndërlidhura në pyje si nga ana e komunitetit ashtu edhe në nivel të shteteve anëtare. Objektivi i përgjithshëm i këtij Plani të Veprimit është që të mbështetet zgjerimi i menaxhimit të qëndrueshëm pyjor dhe sigurimi i rolit shumëfunksional të pyjeve. Plani bazohet në katër parime:

- Programet nacionale pyjore si një kornizë e përshtatshme për zbatimin e përkushtimeve ndërkombëtare të ndërlidhura me pylltari;
- Ngritja e rëndësisë së çështjeve globale dhe ndërsektoriale në politikat pyjore, thirrja për përmirësim të koherencës dhe koordinimit;
- Nevoja për zgjerim të konkurrencës në sektorin pyjor të BE dhe qeverisja e mirë e pyjeve në BE;
- Respekti për parimet e subvencionimit.

Parimet e sipërpërmendura janë konkretizuar edhe më tej përmes zhvillimit të një sërë veprimesh, të cilat janë konsideruar, aq sa ka qenë e mundur, gjatë hartimit të këtij dokumenti strategjik.

Qeveria, gjithashtu është e vetëdijshme për rëndësinë e harmonizimit të projekteve që janë në zbatim e sipër si dhe të punës tjetër zhvillimore me politikat dhe strategjitë e reja.

## 2. GJENDJA E SEKTORIT PYJOR

### 2.1 Resurset pyjore

Nisur prej faktit se informacionet për pyje, kryesisht për trungje, janë mbledhur në periudhën para dhe gjatë viteve 1990 dhe se planifikimet në periudhën para luftës janë bërë vetëm për tokat pyjore publike, një prej veprimeve të identifikuar si më urgjente, ishte bërja valide e të dhënave dhe riinstalimi i kapaciteteve për zhvillimin e një vlerësimi të resurseve pyjore në të gjithë Kosovën, i quajtur Inventarizimi i Pyjeve. Ky lloj i informacioneve është crucial për vendime të ndryshme strategjike, për vendosjen e politikave sektoriale dhe për monitorimin e trendëve pyjore. Duke konsideruar këto kërkesa urgjente, gjatë viteve 2003 - 2004 është zhvilluar një inventarizim i pyjeve në gjithë vendin. Rezultatet dhe konkluzionet kryesore, duke u mbështetur në bazat për politika dhe strategji implementuese, janë elaboruar dhe përmbledhur si në vijim:

- Rreth 379 200 ha janë klasifikuar si toka pyjore përmes interpretimit të aerofotove dhe anketimeve në terren. Ndërsa, 85 600 ha janë klasifikuar si toka pyjore përmes interpretimit të fotove, por nuk janë anketuar për shkak të pengesave nga minat dhe pengesave tjera logjistike. Prej sipërfaqes totale të tokave pyjore që kanë qenë të anketuara dhe jo të anketuara, 278 880 ha janë klasifikuar si toka pyjore publike dhe 185 920 ha si toka pyjore private. Kjo sipërfaqe totale (464 800 ha) është pak më e madhe (6-8%) krahasuar me matjet e mëparshme;
- Pyjet me specie fletore mbulojnë më shumë se 90 % të tokave pyjore. Llojet dominuese të fletorëve janë bingu dhe ahu. Pyjet me specie halore mbulojnë 7 % të tokave pyjore dhe aty dominojnë breu, hormoqi dhe pisha;
- Vëllimi total në këmbë në pyjet publike është vlerësuar të jetë rreth 33.5 milion m<sup>3</sup>. Prej këtij vëllimi, 25.9 milion m<sup>3</sup> janë drunj me diametër >7 cm, në lartësi të gjoksit. Në pyjet private, vëllimi total në këmbë është vlerësuar rreth 19.5 milion m<sup>3</sup> prej të cilave 14.5 milion m<sup>3</sup> janë drunj me një diametër >7 cm;
- Rritja vjetore e drunjve në sipërfaqet e anketuara dhe të cilët janë me diametër >7 cm, në lartësi të gjoksit, është kalkuluar të jetë 1.165 milion m<sup>3</sup>. Ndërsa për sipërfaqet e paanketuara (85 600 ha) që në masë të madhe gjenden afër fushave të minuara apo pjesëve të pavizituara, duket e arsyeshme që të mos përfshihet kjo rritje në bazat për prerje të lejueshme vjetore;

- Është një sipërfaqe e konsiderueshme e tokave pyjore të zhveshura (20 000 – 30 000 ha). Disa prej këtyre sipërfaqeve janë të eroduara dhe kanë një shtresë të rrallë në krye të dheut. Përpos një fertiliteti të dobët, një pjesë e konsiderueshme është e përshtatshme për pyllëzime;
- 40% e tokave pyjore publike dhe 29% e tokave pyjore private u janë nënshtruar aktiviteteve të pakontrolluara apo ilegale të shfrytëzimit. Krahasuar me të gjitha standardet e aplikuara, këto shifra janë mjaft të larta. Situata është shumë kritike sidomos në pyjet halore, ku ekzistenca e sipërfaqeve të gjera pyjore është vënë në rrezik, nëse nuk merren masa të menjëhershme. Rezultatet e inventarizimit gjithashtu konfirmojnë që pyjet e ulëta, veçanërisht ato publike i shtrohen një shfrytëzimi të tepërt. Po ashtu, rezultatet tregojnë, që shumë pyje të reja dhe ato me moshë mesatare të mesme kanë nevojë urgjente për intervenime menaxheriale, duke filluar prej pastrimit/rrallimeve parakomerciale deri te rrallimet komerciale.

## 2.2 Vështirësitë e Sektorit Pyjor

Në aspektin relativ, struktura ligjore për sektorin pyjor është e vendosur. Janë miratuar Ligji për Pyje dhe ligje të tjera të orientuara për pyjet në aspektin e gjerë. Gjithashtu janë miratuar edhe një numër i udhëzimeve administrative. Mirëpo, me gjithë faktin se legjislacioni mbështetës është i vendosur, një prej sfidave që ende mbetet e pranishme është mungesa e respektimit të ligjit, që si duket varet prej arsyeve të shumëfishta, (i) stafi dhe njerëzit me ndikim nuk janë plotësisht të vetëdijshëm për kornizën ligjore, (ii) korniza ligjore nuk referohet si e kuptimplotë, (iii) korniza ligjore neglizhohet shpesh, atëherë kur paraqitet si pengim i operacioneve/aktiviteteve, (iv) mbikëqyrja dhe fuqizimi nuk janë të vendosura, (v) policia, prokuroria dhe sistemi gjyqësorë nuk i procedojnë si duhet raportet për shkelje të ligjit.

Institucioni kryesor përgjegjës për çështjet e pylltarisë në terren (APK), që është krijuar sipas rregullores së UNMIK-ut në vitin 2000, së pari si Autoritet më pas si Agjencion në vitin 2003, është në funksion por ende ka vështirësi të shumta. Kjo gjendje është për shkak të kombinimit të disa arsyeve, siç janë kompetencat e stafit, mungesa e resurseve dhe fondeve, mandatet dhe rolet e paqarta. Planifikimi është joadekuat, si dhe mbikëqyrja ashtu edhe kontrolli. Së fundi, rezultatet e këtyre vështirësive të vazhdueshme mund të dërgojnë në:

- mbledhje nëoptimale të taksave për qeverinë nga shitja e trungjeve dhe produkteve pyjore;
- dhënia e të drejtave për shfrytëzim të pyjeve ndonjëherë bazohet në kritere joformale;

- tregu i drurit që nuk është me transparencë të plotë, kundërpërgjigjet me jopromovim të efikasitetit dhe biznesit të shëndoshë;
- humbje në shfrytëzimin e drurit, veçanërisht aty ku ka shfrytëzim ilegal;
- moszhvillimi i qëndrueshëm i menaxhimit të pyjeve çon në prodhimtari të ulët dhe zvogëlon vlerat e trungjeve, dhe
- pyje të pambrojtura kundër zjarrit dhe insekteve.

Si përmbledhje, dobësitë kryesore të sektorit janë të lidhura me faktet, vështirësitë dhe mungesat si në vijim:

- Pylltaria duhet të jetë prioritet shumë më i lart në agjendën e Qeverisë. Pyjet janë ofrues i rëndësishëm i të mirave materiale dhe mundësive të punësimit, gjithashtu kanë shërbime dhe përfitime të shumëfishta, si: mbrojtja e florës dhe faunës, rekreacioni etj. Të gjitha këto përfitime nuk gëzojnë mirënjohje të plotë nga ana e vendimmarrësve;
- Në krye të prioriteteve duhet të jetë zbatimi i standardeve profesionale në të gjitha nivelet, përkushtimi ndaj detyrave në mesin e pylltarëve dhe ngritja e vetëdijes te publiku i gjerë rreth rëndësisë së sektorit;
- Sektori privat nuk është i zhvilluar si duhet; aspekte të rëndësishme janë reformat institucionale, krijimi i një mjedisi mbështetës për biznesin, privatizimi apo likuidimi i ish-ndërmarrjeve publike pyjore, varësisht nga gjendja e tyre, përkrahja për shoqata të pronarëve të pyjeve dhe pjesë të tjera të komunitetit të biznesit;
- Rolet dhe përgjegjësitë e nivelit qendror dhe atij lokal të qeverisjes duhet të qartësohen dhe jenë më komunikuese dhe në pajtim të plotë mes tyre. Me rëndësi të veçantë është arritja e një pajtimi të përbashkët se si të implementohet më së miri delegimi i kompetencave për menaxhimin e pyjeve, duke marrë parasysh nevojat për koordinim të aktiviteteve investuese dhe mbrojtjen e pyjeve;
- Paqartësitë rreth përgjegjësisë në menaxhim të zonave të mbrojtura duhet të diskutohen dhe qartësohen. Ligji për Pyje përcakton që Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është përgjegjëse për menaxhimin e parqeve nacionale. Sido që të jetë, është evidente që ministria nuk ka kompetenca të plota për ndërmarrjen e përgjegjësisë dhe kështu do të ketë nevojë për të bashkëpunuar me ministritë e tjera relevante për përmbushjen e obligimeve që dalin nga ligji.



### 3. POLITIKAT PËR INTERVENIM NË FUSHAT ME PRIORITET

Tabela e mëposhtme prezanton një numër të fushave të identifikuar për ndërhyrje, të cilat mendohet se kanë një ndikim të madh në sektorin pyjor. Identifikimi i këtyre fushave të përcaktuara për ndërhyrje është rezultat i një procesi konsultativ, në të cilin kanë kontribuar shumë palë të interesit.

**Tabela 1. Fushat e përcaktuara për ndërhyrje**

Fushat për ndërhyrje	Udhëzime
Menaxhimi i pyjeve, silvikultura	Prodhimi i farërave, mbjellja, rrallimet, ndërtimi i rrugëve pyjore dhe mirëmbajtja e tyre
Planifikimi Pyjor	Inventarizimi i pyjeve (plani strategjik), Planet menaxhuese (10-vjeçare), Planet vjetore
Shfrytëzimi dhe Transporti	Caqet e prerjes vjetore (publike/private), shitja e drunjve, mekanizmat e kontrollit,
Ngritja e kapaciteteve	Edukimi/trajnimi, funksionet kërkimore-shkencore, trajnimi për leadership (udhëheqje), ngritja e vetëdijes
Mbrojtja e Mjedisve Pyjore	Kufizimet menaxhuese, zonat e mbrojtura, biodiversiteti, certifikimi i pyjeve
Shfrytëzimi i drurit	Shfrytëzimi optimal i resurseve të tanishme dhe të ardhshme të drunjve (pyjeve)
Zhvillimi i sektorit privat	Çështjet e privatizimit, rolet në administrimin dhe menaxhimin e pyjeve publike (shtetërore), lehtësimet financiare
Produkte Pyjore Jodrusore	Frutat e malit, bimët mjekuese, kërpudhat , etj.

Kjo tabelë paraqet tetë fushat e identifikuar për ndërhyrje, me disa udhëzime dhe shembuj që janë të lidhura me fushat ndërhyrëse respektive. Seksioni i ardhshëm paraqet politikat dhe strategjitë që duhet aplikuar për secilën fushë të ndërhyrjes.

#### 3.1 Menaxhimi i pyjeve dhe silvikultura

##### Politikat

Kosova aspirojnë që të menaxhojë me pyjet në harmoni me deklaratën dhe parimet e konsensusit global të menaxhimit, konservimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm për të gjitha llojet e pyjeve të paraqitura në Aneksin 3 të raportit të Kombeve të Bashkuara për Mjedisin dhe Zhvillimin (Rio De Zhanjero, 3 – 14 qershor 1992), përfshirë edhe parimet e parandalimit, biodiversitetit, barazisë së gjeneratave dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekologjik. Në kuadër të këtij përcaktimi të përgjithshëm politik, kujdes i veçantë do të ketë përkujdesja për pyje të reja, restaurimi i tokave pyjore të

degraduara dhe pyllëzimet. Zbatimi konsistent i këtyre politikave do të rezultojë në ngritje të qëndrueshme të prodhimit pyjor për përfitime të ekonomisë kosovare.

### **Strategjitë**

- Për të lejuar përmirësimin e menaxhimit me pyje dhe rritje të vëllimit në këmbë, shfrytëzimi i lejuar vjetor në tokat pyjore publike dhe private nuk do të kalojë 60 % të rritjes së paramenduar vjetore;
- Përkrahje në krijim të institucioneve efikase për zhvillimin e hulumtimeve aplikative, monitorim të gjendjes shëndetësore të pyjeve, shërbime trajnuese dhe mirëmbajtje të kontakteve me institucione të ngjashme hulumtuese ndërkombëtare;
- Përfshirja e hulumtuesve pyjorë kosovarë në një rrjet të bashkëpunimit rajonal, që mund të përkrah hulumtimet aplikative, shkëmbimin e rezultateve dhe të përvojave si dhe zbatimin e rezultateve në praktika menaxhuese pyjore;
- Për të përcaktuar potencialin e ardhshëm të grumbujve do të zhvillohet një studim i cili do të kalkulojë tokat e zhveshura dhe të degraduara të cilat janë të përshtatshme për pyllëzim. Studimi gjithashtu do të vlerësojë përshtatshmërinë e përbërjes aktuale pyjore, dhe bazuar në kushtet e tokave dhe ato klimatike do të sugjerojë modifikimet në përbërje të llojeve/originës;
- Të fillohet me programe të gjera për përkujdesje ndaj pyjeve të reja dhe atyre të tejdendura që do të rezultojë në: (i) përmirësimin e strukturës së pyjeve; (ii) ngritjen e prodhimit pyjor për drurit për djegie dhe drurit me dimension të vogël, që është i përshtatshëm për përpunim nëpër industri të dizajnuara për këtë lloj madhësie dhe (iii) ofrim i mundësive për punësim të popullatës rurale;
- Krijimi i një baze shkencore për përcaktimin e kriterëve dhe udhëzimeve për konvertimin e pyjeve të reja të degraduara dhe atyre me moshë të re (të ulëta) në pyje me më shumë produktivitet;
- Pyllëzimet duhet të zhvillohen në: (i) vende të zhveshura të kualitetit të mirë, aty ku ekzistenca e tokave të mbjellura nuk vihet në rrezik nga faktorë të jashtëm; (ii) në toka pyjore, ku pyjet janë e vjetra dhe joproduktive, të cilat duhet zëvendësohen me pyje më produktive, dhe (iii) në toka pyjore ku regjenerimi natyral nuk është i pritshëm për një periudhë të arsyeshme kohore. Kur janë konsistente me objektivat menaxheriale, duhet të selektohen speciet autoktone në vend të atyre ekzotike;

- Programi i ardhshëm i pyllëzimit duhet të bazohet në njohurit dhe teknologjitë më të avancuara. Modelet e rritjes, vendndodhjet optimale të llojit së bashku me udhëzimet për mbrojtje dhe përkujdesje duhet të udhëheqin punën;
- Pyllëzimi i tokave të degraduara dhe atyre të zhveshura do të bazohet në përzgjedhje të kujdesshme të metodave të përshtatshme silvikulturore, si dhe analiza të kostos dhe rreziqeve të mundshme;
- Vetëm farërat e certifikuara do të përdoren për prodhimin e fidanëve. Prodhimi miksi i specieve, origjinës dhe lloji i materialit për mbjellje duhet të harmonizohen me kërkesat e programeve afatgjata për pyllëzime;
- Rrugët për qasje në pyje do të ndërtohen dhe mirëmbahen për t'u shërbyer nevojave për intervenime të ndryshme menaxheriale gjatë kohës;
- Për përmirësim të operacioneve pyjore, Qeveria do të krijojë mundësi për trajnim të pronarëve të pyjeve private, ndërmarrësve pyjorë dhe të kontraktorëve. Temat që mund të përfshihen janë përkujdesja për pyjet e reja dhe ato të tejendura, pyllëzimi dhe teknikat e shfrytëzimit.

### **3.2 Planifikimi pyjor dhe menaxhimi i informacioneve**

Objektiv i planifikimit pyjor është që për institucionet shtetërore, publikun, sektorin privat, organizatat joqeveritare, të sigurohen informacione të sakta dhe me kohë rreth gjendjes së resurseve pyjore, nevojave për intervenim, etj. Një sistem i Planifikimit Pyjor konsiston në një numër të moduleve, që janë të zhvilluara për të siguruar të gjitha këto lloje të informacioneve: planifikimi strategjik, planifikimi për menaxhim të pyjeve dhe planifikimi i operacioneve.

#### **3.2.1 Planifikimi strategjik**

##### **Politikat**

Informacionet e sakta rreth gjendjes së resurseve pyjore do të jenë gjithmonë në dispozicion. Në veçanti, politikat e Qeverisë janë që të krijohen dhe të mirëmbahen resurset e përhershme për zhvillim të inventarizimeve nacionale të pyjeve. Këto informacione do të sigurojnë të dhëna për monitorim të resurseve pyjore, bërjen e politikave dhe planifikim strategjik prej autoriteteve qendrore pyjore, në mënyrë që të ruhen dhe të shfrytëzohen produktet drusore në harmoni me zhvillimet e bazës së resurseve pyjore.

## Strategjitë

- Do të krijohen resurse të përhershme për zhvillim të inventarizimeve të pyjeve, përfshirë monitorimin dhe prezantimin e rezultateve. Mjetet e nevojshme buxhetore do të jenë gjithmonë në dispozicion;
- Të dhënat e mbledhura duhet të përpunohen dhe të deponohen ashtu që do të mundësojnë një qasje të lehtë në to dhe që do t'u shërbejnë qëllimeve të kërkuara planifikuese;
- Për të minimizuar koston dhe që të garantohet qasja e lehtë në informacione të sakta, gjithmonë do të përdoret teknologjia më e përshtatshme;
- Për të mbajtur të freskuar bazën e të dhënave, çdo vit do të riinventarizohen një numër i sipërfaqeve të përhershme provë, dhe
- Për të zvogëluar koston si dhe kërkesat për resurse, inventarizimet e pyjeve, në masën që është e mundshme teknikisht, do të koordinohen me aktivitetet e planifikimit të menaxhimit pyjor.

### 3.2.2 Planifikimi i Menaxhimit Pyjor

#### Politikat

Për t'u përkrahur një planifikim i menaxhimit efikas, gjithmonë duhet të jenë në dispozicion bazat e të dhënave aktuale - hartat e grumbujve. Për t'u realizuar ky qëllim, politikat e përcaktuara janë që të prodhohen plane aktuale për gjithë Kosovën dhe që mbështesin zbatimin e metodave të qëndrueshme të menaxhimit pyjor. Kjo do të lehtësojë seleksionimin e zonave prioritare pyjore (paraleleve), të cilat do t'i nënshtrohen intervenimeve menaxheriale për një periudhë të dhjetë viteve të ardhshme.

#### Strategjitë

- Qeveria do të caktojë një apo disa institucione, që kanë kapacitete të veta apo të huazuara nga jashtë, për të marrë përgjegjësinë e plotë në hartimin e planeve menaxhuese për rreth 30. 000 ha të tokave pyjore në vit;
- Planet menaxhuese duhet të mbulojnë aktivitetet për së paku dhjetë vite, të shpjegojnë efektet e pritshme të aktiviteve në pyje dhe të jenë konsistente me standardet e Ligjit për Pyje;
- Planifikimi i menaxhimit të pyjeve duhet që të ketë parasysh në mënyrë të kujdesshme nevojat për produkte të ndryshme drunore për popullatën lokale dhe komunitetin e biznesit, sikurse edhe potencialet shumëfunktionale të pyllit;
- Për të zvogëluar koston e hartimit të planeve të reja dhe për të siguruar disponueshmërinë e informacioneve aktuale, planet menaxhuese duhet të përditësohen në mënyrë të vazhdueshme

përmes rezultateve të Planifikimeve Operacionale.

- Para miratimit të një plani menaxhues, drafti duhet të botohet në media për diskutim mes palëve të ndryshme të interesit, degëve përgjegjëse qeveritare, komunave/tokave ku vepron plani;
- Që të sigurohet përdorimi i mirëfilltë i mjeteve buxhetore dhe i resurseve të tjera për planifikim intensiv të operacioneve, duhet të merren parasysh faktorët, si: vlera e llojit të pyllit, rolet e shumëfishta dhe potencialet e pyllit e të tokave pyjore, nevojat për masa mbrojtëse etj;
- Aktivitetet planifikuese, së pari, duhet të koncentrohen në zonat dhe subjektet me rëndësi strategjike, duke respektuar faktorët, si: nevoja për mbrojtje, intervenimet, mundësitë e punësimit dhe qëllimet zhvillimore nacionale;
- Në tokat pyjore private, për planifikim të menaxhimit pyjor do të aplikohen kritere të veçanta.

### **3.2.3 Planifikimi i Operacioneve**

#### **Politikat**

Planifikimi i kujdesshëm operacional është mjeti më i mirë për të zvogëluar ndikimet negative në tokat pyjore të cilat mund të ndodhin nga aktivitetet pyjore. Për këtë arsye, politikat e Qeverisë janë që: (i) të miratojë plane menaxhuese operationale që përshkruajnë shfrytëzimin, silvikulturën si dhe aktivitete të tjera për secilën sipërfaqe të administruar; (ii) të konsultohen komunat e interesuara dhe palë të tjera të interesit para miratimit të planeve, dhe (iii) të sigurohet konsistenca e planeve operationale me Planet e Menaxhimit Pyjor.

#### **Strategjitë**

- Institucioni i caktuar nga Qeveria, do të punojë me kapacitetet e veta apo të huazuara nga jashtë, do të jetë përgjegjës për grumbullimin, përpunimin, prezantimin e të dhënave. Të dhënat do të përmbajnë baza për kalkulim të buxhetit, nevojat për resurse, druri i prodhuar etj. Kërkesat për të dhëna (lloji dhe cilësia) duhet të specifikohen nga dega qeveritare përgjegjëse;
- Të gjitha planet operationale do të jenë në përputhje me rekomandimet e Planeve të Menaxhimit Pyjor. Planifikimi i operacioneve do të marrë në konsideratë nevojat për vitin në vijim të produkteve pyjore drusore, si nga komuniteti lokal, po ashtu edhe ai i biznesit.
- Për të lejuar konsultimet dhe kalkulimet e buxhetit, planet operationale duhet të hartohen jo

më larg se muaji tetor, ndërsa regjistrimet për vitin e kaluar duhet të kompletohen më së largu deri në fund të muajit mars;

- Nëse nuk ka asnjë plan për një zonë të caktuar, institucioni përgjegjës mund vetëm të miratoj planin operacional i cili deklaron se është konsistent me qëllimet dhe standardet e përcaktuara në Ligjin për Pyje;
- Për të minimizuar koston e administrimit, menaxhimi dhe investimi në infrastrukturë, përmes operacioneve vjetore pyjore, duhet të koncentrohet vetëm në disa zona, ashtu siç është e mundur praktikisht.

### 3.3 Shfrytëzimi dhe transporti i drurit

#### Politikat

Rregullat për shfrytëzim dhe transport të drurit janë përcaktuar në Ligjin për Pyje dhe Udhëzimet Administrative. Ligji përcakton rregullat për lëshimin e licencave për shfrytëzim, shenjëzim të trungjeve për prerje, proceduarat për shitje dhe restriksionet në lëvizje dhe transportin e produkteve drusore. Me qëllim që të zvogëlohen aktivitetet jologjore, rregullat janë të detajuara dhe strikte, dhe me disa ndryshime, ato zbatohen për pyjet publike dhe private.

Këto politika bazohen në tri shtylla: në mënyrë që të mundësohet përmirësimi i gjendjes së pyjeve (i) caqet e shfrytëzimit do të jenë shumë më të ulëta se sa është e paramenduar rritja, (ii) përmes zbatimit të mekanizmave që janë dëshmuar si efektiv, masa e aktiviteteve ilegale do të zvogëlohet, dhe (iii) përmirësimi i praktikave shfrytëzuese do të dërgoj në zvogëlimin e dëmtimeve në drunjte e mbetur dhe tokat pyjore si dhe rreziqet për atakim të pyjeve nga insektet dhe dëmtuesit tjerë.

#### Strategjitë

- Në mënyrë që të zvogëlohen aktivitetet ilegale, përveç masave të përgjithshme për mbrojtje të pyjeve si dhe mekanizmave tjerë të kontrollit, Qeveria do të:
  - Mbështet promovimin e sistemeve të menaxhimit të përbashkët të pyjeve për pyjet e ulëta, dhe atje ku pjesa dërrmuese e grumbullit është dru për djegie;
  - Përmes rimarrjes së kontrollit të shfrytëzimit të resurseve pyjore, dhe për të siguruar disponueshmërinë e produkteve drusore, caqet zyrtare të shfrytëzimit do të ngritën në mënyrë proporcionale me masën e zvogëlimit të operacioneve ilegale të shfrytëzimit të drurit;

- Anëtarët e Shoqatave të Pronarëve të Pyjeve Private dhe pjesë të tjera të komunitetit të biznesit, që janë zotuar se nuk do të përfshihen në praktika pyjore ilegale do të shpërblehen me licenca për shfrytëzim dhe leje për transport të produkteve drunore përmes procedurave të thjeshta;
- Praktikrat e shfrytëzimit të pyjeve do të përmirësohen përmes zbatimit të: (i) sistemit të Certifikimit të Pyjeve, (ii) promovim të teknologjisë së përshtatshme, dhe (iii) edukim dhe trajnim për kontraktorët dhe afaristët pyjor.

### 3.4 Ndërtimi i kapaciteteve

#### Politikat

Gjatë dekadave të fundit, mundësitë për edukim dhe trajnim kanë qenë të kufizuara. Kjo situatë ka prekur seriozisht zhvillimin e shumë sektorëve, përfshirë edhe sektorin pyjor. Në pylltari një pjesë e madhe e stafit ekzistues është edukuar në sistemin e vjetër socialist dhe që nga atëherë me shumë pak mundësi, apo fare për rifreskime të njohurive. Për të ndërprerë këtë, nevojitet promovimi i politikave të reja të cilat janë të bazuara në parime që kanë për synim ekonominë e hapur ndaj tregut. Gjithashtu, prioritet i lartë duhet të jetë edhe krijimi i mundësive për edukim dhe trajnim cilësor për të gjitha kategoritë e stafit që punon në sektorin pyjor.

Përball këtij sfondi, politikat e përcaktuara janë që: (i) të organizohet një edukim profesional i mirëfilltë për profilin e pylltarisë; (ii) të zhvillohet një sistem i qëndrueshëm i aftësimeve profesionale për aktivitete pyjore; (iii) të krijohen mundësi për zhvillimin e arsimit të lartë për pylltari, apo vijim të rregullt të tij nga studentët kosovar; (iv) të mundësohet një mobilizim ndërsektorial për ngritje të vetëdijes rreth rëndësisë së pyjeve dhe (v) të vlerësohen nevojat për krijim të premisave për hulumtime shkencore.

#### Strategjitë për zhvillimin e arsimit profesional për pylltari

- Hapja e një shkolle të mesme profesionale për pylltari në nivel kombëtar. Infrastruktura e kësaj shkolle duhet të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare për zhvillim të procesit mësimor për profilin e pylltarisë;
- Të hapet dhe të jetë funksionale një qendër rajonale (Ballkani Perëndimor) për arsim dhe trajnim për pylltari;
- Në bashkëpunim me institucionet e tjera, Shkolla e Mesme e Pylltarisë do të jetë përgjegjëse për ndërmarrjen e fushatës së vetëdijesimit rreth rëndësisë së pyjeve. Aktivitetet do të

fokusohen, por nuk do të kufizohen në fushatë mediatike, organizim të debateve dhe përmbledhje të informacioneve që do të përfshihen në tekstet shkollore.

### **Strategjitë për zhvillimin e aftësimeve profesionale për pylltari**

- Krijimi i një Qendre për Aftësime Profesionale për Pylltari e cila do të shërben për të ngritur shkathtësitë e punëtorëve pyjorë. Institucioni do të organizohet dhe operojë në të gjithë Kosovën. Për të plotësuar nevojat e ndryshme trajnuese, aftësimet do të ofrohen përmes një sistemi të bazuar modular.
- Përmes ofrimit të shërbimeve për aftësime profesionale do të rriten mundësitë e popullatës për vetëpunësim, ndërmarrësi dhe aplikimi i metodave të punës me siguri të lartë.

### **Strategjitë për organizim të arsimit të lartë dhe të hulumtimeve në pylltari**

- Të hapet një fakultet i pylltarisë në Prishtinë, apo të ofrohen mundësi për studime në fushën e pylltarisë jashtë vendit;
- Krijimi i një bashkëpunimi ndërministror, zhvillimi i plan-programit, vlerësim i nevojave për trajnime dhe sigurimi i fondeve për zbatim të përhershëm të premisave të arsimimit të lartë;
- Krijimi i kapaciteteve për: (i) hulumtime aplikative përmes institucioneve të reja apo fuqizimi i atyre ekzistuese dhe (ii) sigurimi i disponueshmërisë së teknologjisë moderne përmes lidhjeve të hulumtuesve pyjorë kosovarë me institucionet hulumtuese ndërkombëtare.

## **3.5 Mbrojtja e mjediseve pyjore**

### **Politikat**

Pylli është një ekosistem i komplikuar dhe me një rëndësi të veçantë jo vetëm në ruajtjen e biodiversitetit, por edhe për shoqërinë në tërësi përmes aspekteve shkencore, edukative, nevojave kulturore, atyre rekreative dhe shëndetësore, si dhe dimensioneve tjera estetike që influencojnë turizmin, etj.

Duke marrë parasysh këto funksione të rëndësishme, politikat e përgjithshme të përcaktuara për këtë fushë janë që të sigurojnë rolin e pyjeve si kontribues të mëdhenj në mbrojtjen e mjedisit, biodiversitetit, zvogëlimit të gazrave serrë dhe zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofat natyrore. Aspekte të veçanta që do të përfshihen këtu, janë: hulumtimet, përcaktimi i kritereve për shpalljen e zonave të mbrojtura, sistemet dhe masat mbrojtëse dhe ngritja e vetëdijes për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit.



## Strategjitë

- Qeveria do të sigurojë fonde për krijimin e kapaciteteve për hulumtime dhe inventarizim të biodiversitetit, si dhe mbështetje për identifikimin dhe përcaktimin e zonave të mbrojtura;
- Shpallja dhe menaxhimi i zonave të mbrojtura do të bazohet në kritere të pranueshme ndërkombëtare, sikur edhe planifikimi i tyre i mirëfilltë, përfshirë ekspertizën e nevojshme dhe palët relevante të interesit;
- Do të hartohet një plan menaxhimi për secilën zonë të shpallur të mbrojtur. Plani duhet të përkufizojë dhe të përcaktojë objektivat dhe qëllimet e mbrojtjes, përgjegjësitë e institucioneve qeveritare relevante, si dhe nevojat për ndërhyrje menaxheriale;
- Masat e nevojshme që synojnë rikthimin dhe konservimin biologjik, si dhe diversitetet e peizazheve do të jenë pjesë integruese e praktikave menaxhuese pyjore;
- Përmes objektivit primar të nxitjes së praktikave të qëndrueshme të menaxhimit pyjor, Qeveria do të mbështesë zbatimin e skemave të Certifikimit Pyjor;
- Plani i Veprimit për biodiversitet do të përfshijë elementet vijuese:
- Ngritjen e kapaciteteve tek institucionet përgjegjëse për biodiversitet, mbrojtjen dhe trashëgiminë natyrore;
- Zhvillimin e një inventarizimi për të përcaktuar kufijtë e zonave mbrojtëse, të florës dhe faunës;
- Bashkëpunimin ndërsektorial për të siguruar përfshirjen e çështjeve të biodiversitetit dhe të trashëgimisë natyrore nëpër proceset planifikuese;
- Nevojat për investime në aktivitetet që janë të lidhura me menaxhimin e zonave të mbrojtura;

### 3.6 Shfrytëzimi i drurit – zhvillimi i industrisë pyjore

#### Politikat

Ligji për pyje thotë që tokat pyjore do të shfrytëzohen në mënyrë efikase duke synuar vjelje të qëndrueshme të vlerave dhe produkteve pyjore dhe të cilat janë me përbërje që kanë potencial për të përmbushur nevojat e ndryshme të familjeve në Kosovë. Për t'u përputhur me këto qëndrime, politikat e Qeverisë do të mbështeten në: (i) përkrahje të zhvillimit të industrisë konkurruese të drurit, e cila është e aftë për të përfituar nga përpunimi primar (sharrat) dhe prodhimi i energjisë; (ii)

të kontribuojë në krijimin e një tregu stabil të drurit dhe (iii) përkushtim në krijimin e lehtësirave financiare për ata individë, shoqata, etj. që kanë kapacitete për të investuar në industrinë pyjore me shkallë të mesme dhe të vogël.

### **Strategjitë**

- Në harmoni me shfrytëzimin e qëndrueshëm të vëllimit drusor, përbërjen dhe lokacionin e tij, Qeveria do të mbështetë investitorët nga sektori privat, që janë të gatshëm të investojnë në industrinë konkurruese të drurit e cila është e aftë për të krijuar përfitime nga përpunimi primar (sharrat) dhe prodhimi i energjisë. Prioritet do të ketë krijimi i industrive me kapacitete të mesme dhe të vogla, të cilat në masë të madhe mund të shfrytëzojnë lëndën e parë prej zonave lokale ku veprojmë;
- Me objektiv të ofrimit të udhëzimeve dhe këshillave, Autoritetet Qeveritare Pyjore do të sigurojnë të dhëna, sipas kërkesave, rreth resurseve pyjore për investitorët në industrinë pyjore;
- Veçanërisht në zonat rurale, druri mbetet burim i rëndësishëm i energjisë për ngrohje. Për këtë arsye strategjia e Qeverisë është që të mbështetet përkrahjen e sistemeve dhe metodave që udhëzojnë përmirësimin e prodhimtarisë dhe shfrytëzimin e resurseve pyjore që janë optimale për prodhim të energjisë;
- Qeveria do të mbështetë krijimin e lehtësirave që do të ofrohen për shoqata të pronarëve të pyjeve private, ndërmarrës dhe individë të cilët janë të interesuar për investime në zhvillimin e industrisë pyjore me kapacitete të vogla dhe të mesme;
- Pas shumë vjetësh të shkatërrimit të ekonomisë, kapitalit njerëzorë dhe makinerisë, nevojat për investime në teknologjinë moderne janë të konsiderueshme. Për këtë arsye, Qeveria do të shikojë mundësitë e nxitjes së kredive financiare, me kamatë më të vogël sesa nga ato komerciale si dhe me periudhë grejs të zgjatur. Lehtësime të tilla financiare do të jenë në dispozicion për investitorët privatë me objektiv të stimulimit për rehabilitim në një mënyrë të synuar, të industrisë së drurit.

### **3.7 Zhvillimi i sektorit privat**

#### **Politikat**

Sektori privat përfshin individët që posedojnë pyje (rreth 40% e gjithë tokave pyjore), ndërmarrjet dhe afaristët që janë të përfshirë në operatione pyjore dhe/apo përpunues të drurit në shkallë të vogël. Sipërfaqja mesatare e pronës pyjore private është në vijë me 1.5 ha, e cila sipërfaqe është e

ndarë në 2.4 parcela. Duke konsideruar këtë strukturë të fragmentuar të pronësisë, mundësitë për menaxhim të tokave janë seriozisht të kufizuara. Sido që të jetë, kjo situatë e pronësisë së pyjeve private nuk është e veçantë për Kosovën, por e ngjashme me shumë vende të Evropës Qendrore. Sektori i përpunimit të drurit është gjithashtu i fragmentuar dhe vepron me pajisje të vjetruara. Duke marrë parasysh këtë situatë, politikat e përcaktuara të Qeverisë janë që: (i) të përkrahë krijimin e shoqatave që përfaqësojnë interesat e palëve të ndryshme të interesit; (ii) të krijojë një mjedis të favorshëm për biznes; (iii) të krijojë mundësi që sektori privat të zhvillojë menaxhimin e tokave pyjore publike dhe (iv) të inicioj procesin e konsolidimit të tokave. Strategjitë për zbatim të këtyre politikave janë të prezantuara më poshtë.

### **Strategjitë**

- Qeveria do të nxitë krijimin e shoqatave që përfaqësojnë interesat e grupeve të ndryshme, si: pronarët e pyjeve private, ndërmarrësit dhe kompanitë që janë të përfshira në operacionet pyjore dhe përpunuesit e drurit;
- Gjatë zhvillimit të ardhshëm të pylltarisë dhe sektorit të industrisë pyjore, komuniteti i biznesit privat do të luajë një rol kyç. Për këtë arsye, dhe për të siguruar zbatimin e strategjive zhvillimore, komuniteti i biznesit privat do të ftohet gjithmonë për të marrë pjesë në përcaktimin e politikave dhe në hartimin e legjislacionit;
- Qeveria do të përkrahë krijimin e një mjedisi të favorshëm për biznes. Kjo do të përfshijë, por jo në mënyrë të kufizuar, zbatimin e politikave fiskale për mbështetje të zhvillimit të dëshiruar dhe përkrahje aktive në krijimin e lehtësirave financiare për ofrimin e investimeve kapitale me kamatë të vogël dhe grejs periudhë të përshtatshme;
- Qeveria do të mbështesë sistemet e menaxhimit të përbashkët, në të cilin komunitetet lokale, shoqatat e pronarëve të pyjeve dhe ndërmarrësit me shkathësi dhe me kapacitete të dëshmuara marrin përgjegjësi në menaxhim të pyjeve për zona të caktuara. Prioritet do të kenë zonat me pyje të ulëta dhe ato ku pjesa dërrmuese është e përbërë me drunj për djegie si dhe zonat ku ekzistojnë planet e reja menaxhuese;
- Privatizimi dhe likuidimi i ish-Ndërmarrjeve Shoqërore duhet të kompletohet sipas politikave dhe strategjive të aplikuara;
- Me qëllim të sigurimit të një menaxhimi sa më efikas të tokave pyjore private, Qeveria do të iniciojë procesin e konsolidimit të tokave. Ky proces mund të përfshijë edhe shitjen e tokave

pyjore publike, të cilat me mundësitë e tyre do të kenë një vlerë më të madhe nëse janë në pronësi private.

### **3.8 Produktet pyjore jodrusore**

#### **Politikat**

Produktet pyjore jodrusore (frutat pyjore, kërpudhat, bimët aromatike dhe mjekësore, ekoturizmi) mund të jenë me një rëndësi ekonomike të konsiderueshme për popullatën rurale. Në Kosovë, shfrytëzimi i këtyre produkteve dhe shërbimeve nuk është i organizuar mirë. Arsyeja kryesore për këtë gjendje është mungesa e legjislacionit përkrahës.

Me rëndësi të posaçme është hartimi i një ligji i cili do të rregullonte grumbullimin e bimëve mjekuese dhe atyre aromatike, sipas standardeve ndërkombëtare (ISSC –MAP). Zbatimi i një ligji të tillë do të krijonte baza për shfrytëzim, grumbullim, përpunim dhe tregtim me bimë mjekuese dhe aromatike. Duke respektuar parimet e shfrytëzimit të qëndrueshëm dhe mbrojtjes së biodiversitetit, gjithashtu do të krijoheshin të hyra për popullatën rurale dhe do të sigurohej një konsistencë me Qëllimet Zhvillimore të Mijëvjeçarit (UN 2005).

Për këtë arsye, politikat e përcaktuara janë që të inkurajojnë shfrytëzimin e produkteve pyjore jodrusore përmes një menaxhimi të integruar të tokave pyjore dhe sipas shfrytëzimit të qëndrueshëm të të gjitha llojeve të produkteve pyjore jodrusore, pastaj përfshirë edhe parimet e parandalimit, barazisë së gjeneratave, konservimit të larmisë biologjike dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekologjik.

Në tokat pyjore ku bëhet nxjerrja e gurëve, rërës dhe zhavorrit do të operohet në pajtim të plotë me nevojat për kufizim të ndikimeve negative në mjedis. Pas përfundimit të operacioneve mihëse, ato vende ku është punuar duhet të rehabilitohen nga operatori pa asnjë çmim kompenzues ndaj pronarit të tokës. Gjatë operacioneve, operatori duhet të mbajë kontakte të ngushta me institucionet qeveritare përgjegjëse për administrimin e tokave pyjore.

Menaxhimi i kafshëve të egra, rregulluar sipas Ligjit për Gjueti, do të koordinohet me aktivitete pyjore nën administrimin e Agjencionit Pyjor të Kosovës dhe Departamentit për Pylltari.

#### **Strategjitë**

- Hartimi i legjislacionit që do të rregullojë grumbullimin e bimëve mjekësore dhe atyre aromatike bazuar në standardet ndërkombëtare;
- Inventarizimi dhe analiza hartografike e potencialeve për prodhimtari të bimëve mjekuese dhe aromatike;

- Certifikimi dhe licencimi i ndërmarrjeve të përfshira në grumbullimin dhe përpunimin e bimëve mjekuese dhe aromatike;
- Nxitja e metodave dhe praktikave për një shfrytëzim miqësor ndaj mjedisit si dhe produkteve pyjore jodrusore dhe që janë në harmoni me shfrytëzimin e qëndrueshëm;
- Përkrahja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme për aktivitete të lidhura me produktet pyjore jodrusore dhe me objektiva të rritjes së punësimit dhe të mundësive për krijim të të ardhurave;
- Me objektiv të rritjes së përfitimeve nga ekoturizmi, strategjia synon që të përkrahet bashkëpunimi në mes aktorëve që mund të ofrojnë vlera shtesë.

## **4. KORNIZA PËR IMPLEMENTIMIN E STRATEGJISË**

### **4.1 Principet që duhet aplikuar**

Spektori pyjor në Kosovë mund të kontribuojë në stabilitetin social dhe në përmirësim të sigurisë. Mjetet të cilat mund të shfrytëzohen këtu janë përparësitë e kapaciteteve pyjore për të shpërndarë produkte të rëndësishme jetësore përmes cilave mund të zvogëlohet varfëria dhe në këtë mënyrë edhe përmirësimi dhe zhvillimi i gjendjes shoqërore-ekonomike. Aktivitetet pyjore mund të ofrojnë punësim dhe ngritje të mundësive për sektorin privat në ofrimin e shërbimeve. Organizimi i pronarëve të pyjeve, mbështetja OJQ-ve, ngritja e vetëdijes, forcimi i koekzistencës etnike, etj. janë disa aktivitete që do të fuqizojnë shoqërinë civile dhe do të kontribuojnë në proceset demokratike. Zbatimi i projekteve dhe punës tjetër zhvillimore do të ndërtohet në këto fundamente.

Strategjitë e prezantuara synojnë që të qeverisin zhvillimin e sektorit të pylltarisë gjatë dhjetë viteve të ardhshëm, ato bazohen në analiza paraprake, që janë të përmbledhura në tabelën 2 (pjesa 4.5). Gjatë zhvillimit të procesit, janë identifikuar një numër i zbrazësive në njohuri. Gjithashtu është e qartë se disa fusha, pavarësisht mbështetjes së mëhershme ende janë të dobëta dhe kanë nevojë për përkrahje të mëtejme dhe të ndryshme për të arritur potencialin e tyre të plotë. Veç kësaj, është gjithashtu shumë e qartë se zbatimi i suksesshëm i të gjitha këtyre strategjive kërkon një koordinim të kujdesshëm dhe mbështetje të përkushtuar prej të gjitha institucioneve përgjegjëse kosovare.

Korniza për zbatimin e strategjive të përcaktuara është e bazuar në tri shtylla:

- (i) projekte të hartuara për ngritjen e njohurive në fushat e pazhvilluara;
- (ii) mbështetje për përmirësim të operacioneve dhe ndryshim të veprimeve, dhe
- (iii) mbështetje për institucionet e Qeverisë që kanë përgjegjësi të plotë për zbatimin e strategjisë.

Pjesët në vijim paraqesin projektet kryesore, aktivitetet, etj. të përfshira në këto tri shtylla, të cilat janë zhvilluar edhe më gjerësisht në një dokument të veçant, i quajtur “Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë së Pylltarisë 2010 – 2020”, i cili do të jetë instrument udhëzues në procesin e zbatimit të strategjisë.

### **4.2 Projektet e kërkuara për ngritje të njohurive në fushat e pazhvilluara (Shtylla I)**

Katër projekte kryesore kërkohen për të ngritur kompetencat në fushat e pazhvilluara të sektorit pyjor. Është parashikuar që zbatimi i këtyre projekteve do të ketë nevojë për asistencë ndërkombëtare dhe mbështetje financiare prej organizatave donatore.

**Ngritja e produktivitetit nga pyjet dhe tokat pyjore**

Një program i hollësishëm për menaxhimin e pyjeve dhe silvikulturën me një objektiv të përgjithshëm për mbështetje dhe promovim të praktikave të përmirësuara menaxheriale pyjore të cilat do të çojnë te ngritje të produktivitetit nga pyjet dhe tokat pyjore në të dy perspektivat, atë afatmesme dhe afatgjatë, dhe përmes gjithë kësaj të mundësohet ngritja e kontributit të sektorit pyjor në ekonomin nacionale dhe krijimin e mundësive të punësimit (shih tabelën 2, Fusha ndërhyrëse A);

**Ndërtimi i kapaciteteve**

Këtu ka nevoja urgjente për edukim dhe trajnim të vazhdueshëm rreth shumicës së çështjeve në kuadër të sektorit pyjor. Në këtë aspekt sugjerohet që: (i) të organizohet një edukim i mirëfilltë parauniversitar profesional për profilin e pylltarisë; (ii) të zhvillohet një sistem i qëndrueshëm i aftësimeve për aktivitete pyjore; (iii) të krijohen mundësi për zhvillim të arsimit të lartë për pylltari apo ndjekje të tij jashtë vendit; (iv) mobilizim ndërsektorial për ngritje të vetëdijes rreth rëndësisë së pyjeve, dhe (v) vlerësimi i nevojave për krijim të premisave për zhvillimin e hulumtimeve shkencore (shih tabelën 2, Fusha ndërhyrëse D).

**Mbrojtja e mjediseve pyjore dhe zhvillimi i vlerave jodrusore**

Objektiv i këtij projekti është që të sigurohet roli i pyjeve si kontribues në biodiversitet dhe prodhues të vlerave jodrusore, zvogëlim të gazrave serrë dhe të rreziqeve nga katastrofat natyrore. Elemente të rëndësishme në këtë projekt janë, krijimi i resurseve për zhvillim të hulumtimeve, hartimin e legjislacionit, hartimin e planeve të veprimit për biodiversitet dhe identifikimi i zonave të mbrojtura (shih tabelën 2, Fusha ndërhyrëse E dhe G).

**Zhvillimi i sektorit privat**

Mbështetje për sektorin privat (pylltari dhe industri pyjore), përfshirë menaxhimin e pyjeve, shoqata të pronarëve të pyjeve private, proceset e konsolidimit të tokave, promovim të menaxhimit të përbashkët, zhvillim të industrisë për përpunim të drurit me shkallë të vogël të cilat do të operojnë në zonat rurale, ku edhe burime të lëndës së parë i kanë tregjet lokale, krijimi i lehtësirave financiare etj. (shih tabelën 2, Fusha ndërhyrëse F).

**4.3 Mbështetje për përmirësimin dhe ndryshimin e operacioneve (Shtylla II)**

Kjo shtyllë paraqet dy fusha kryesore, të cilat pavarësisht përkrahjes së mëhershme ende janë në gjendje të dobët dhe si të tilla kanë nevojë të mëtejshme për mbështetje përmes formave të ndryshme në mënyrë që të arrihet potenciali i tyre i plotë. Të dy këto fusha kanë të bëjnë me pjesë vitale të sektorit pyjor dhe kështu performanca e përmirësuar aty, do të ketë ndikim të madh në gjithë sektorin, përfshirë edhe kontributin në ekonomin e gjithëmbarshme nacionale.

Institucionet e Kosovës duhet të marrin përgjegjësinë e plotë për zbatimin e veprimeve që janë të lidhura me fushat e paraqitura në këtë shtyllë. Duke konsideruar mbështetjen e ofruar gjatë viteve, mendohet që institucionet e ndërlidhura do të kenë kapacitete që, me mjete të veta apo mbështetje teknike të kufizuar prej donatorëve, të zbatojnë veprimet dhe ndryshimet e kërkuara.

### **Planifikimi pyjor (tabela 2, Fusha ndërhyrëse B)**

Përkrahja ndërkombëtare për zhvillimin e planifikimit pyjor (shih tabelën 2, Fusha ndërhyrëse B) ka filluar qysh në vitin 2002, dhe, me disa ndërprerje, ka vazhduar deri më sot. Gjatë fazës fillestare, mbështetja teknike ka qenë e orientuar në inventarizimin e pyjeve, ndërsa mbështetja gjatë katër vjetëve të fundit ka qenë e koncentruar në planifikimin e menaxhimit pyjor. Pavarësisht nevojave për mbështetje të vogël teknike, mund të konkludohet që institucionet e Kosovës (APK) kanë arritur kompetenca të nevojshme teknike për zhvillimin e vazhdueshëm (me resurset e veta) të operacioneve planifikuese.

Planifikimi i operacioneve nuk është zhvilluar në mënyrë të duhur. Kjo është treguar me praktika jo të qëndrueshme shfrytëzuese, duke rezultuar me humbje të vlerave dhe atakim nga insektet dhe dëmtues tjerë. Për të përmirësuar gjendjen, aty kërkohen ndryshim i qëndrimeve dhe trajnime të mëtejshme.

### **Përmirësim i operacioneve të shfrytëzimit dhe të transportit (tabela 2, Fusha ndërhyrëse C)**

Standardet e operacioneve të shfrytëzimit dhe transportit (shih tabelën 2, Fusha ndërhyrëse C) janë shumë afër të lidhura me cilësinë e planifikimit të operacioneve. Këtu kemi tri veprime kryesore për t'u zbatuar, të gjitha këto janë të lidhura me zvogëlimin e praktikave joligjore dhe me përmirësimin e operacioneve pyjore.

- Nëse zbatohen në mënyrë të duhur, instrumentet e vendosura legale janë të fuqishme sa duhet për të ndaluar të gjitha aktivitetet joligjore. Në aspektin relativ struktura legale është e vendosur. Aty është Ligji për Pyje dhe ligje të tjera me orientim në aspektin e gjerë kah pyjet. Gjithashtu janë edhe një numër i udhëzimeve administrative. Të gjitha këto instrumente legjislative duhet të zbatohen më mirë;
- Përvojat prej të gjitha rajoneve tregojnë që sistemet e mbrojtjes, duke përdorur zbatimin e ligjit si të vetmin mjet për zvogëlim të aktiviteteve joligjore, nuk mund të jetë efikas sa duhet. Për këtë arsye rekomandohet që të zbatohen sistemet e menaxhimit të përbashkët të pyjeve dhe ngritja e vetëdijes te publiku për rëndësinë e pyjeve;



- Është e nevojshme që të promovohen teknologjitë dhe pajisjet e reja, të cilat janë të disenjuara për llojet e pyjeve dhe kushtet e terrenit, që do të jenë cak për intervenime në të ardhmen.

#### **4.4 Mekanizmat për të mbështetur zbatimin e strategjisë (Shtylla III)**

Zbatimi i suksesshëm i Strategjisë do të kërkojë një koordinim të kujdesshëm të projekteve dhe punës tjetër zhvillimore. Pylltaria është e vendosur në MBPZHR dhe ky institucion sugjerohet që të jetë zbatuesi kryesor i strategjisë. Por, duke marrë parasysh natyrën e aktiviteteve, radhitur prej aspekteve të pastra teknike se si të menaxhohet me toka pyjore, me edukimin, mjedisin shoqëroro-ekonomik, me çështje industriale etj, është e rrugës që edhe një numër i ministrive të tjera dhe palë të interesit të përfshihen në zbatimin e këtij programi. Kjo situatë komplekse, si dhe kohëzgjatja e aktiviteteve lë për t'u kuptuar që MBPZHR duhet të ketë kapacitete për të organizuar, koordinuar dhe monitoruar punën e gjithëmbarshme. Për të përkrahur MBPZHR-n në këtë aktivitet, rekomandohet fuqishëm që të krijohet një Bord Menaxhues i cili do të ketë përgjegjësi të përgjithshme për realizimin e të gjitha aktiviteteve që dalin për zbatimin e strategjisë. Mandati dhe struktura organizative e këtij Bordi duhet të jenë të precizuara përmes një marrëveshjeje të krijuar së bashku mes ministrive të ndërlidhura.

Një prej detyrave të rëndësishme të Bordit Menaxhues do të jetë monitorimi i vazhdueshëm dhe analiza e rezultateve të dala nga puna zhvillimore dhe bazuar në këto konkluzione të bëhet hartimi detaj i planit të aktiviteteve. Objektivi i kësaj detyre do të jetë edhe harmonizimi i përpjekjeve të ndryshme zhvillimore si dhe të shmanget duplikimi dhe ndërhyrja mes aktiviteteve.

Përpos aktiviteteve dhe mbështetjes që është theksuar përmes planit zhvillimor, është llogaritur që mund të kërkohej edhe mbështetje tjetër e herëpashershme dhe në forma të ndryshme (institucionale dhe teknike), e cila nuk mund të ofrohet përmes aktiviteteve të parapara. Shembuj të nevojave për mbështetje të tillë mund të jenë krijimi i rrjeteve dhe kontakteve ndërkombëtare, valorizimi dhe çështjet financiare, hartimi i projekt propozimeve, etj. Ndërtimi organizativ, përshkrimi i detyrave, lokacioni etj. duhet të jenë subjekt pajtimi dhe në lidhje me krijimin e Bordit Menaxhues.

#### **4.5 Përmbledhje e aktiviteteve për zbatimin e strategjisë**

Detyrat kryesore zhvillimore që kërkohen për zbatimin e strategjisë janë të përmbledhura në tabelën e mëposhtme. Për secilën fushë të ndërhyrjes janë prezantuar aktivitetet kryesore, rezultatet e pritshme, ndërlidhjet mes fushave ndërhyrëse dhe aktiviteteve implementuese si dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin e tyre.

Tabela 2 Zbatimi i Strategjive

Fusha për ndërhyrje	Aktivitetet	Rezultatet e pritshme	Ndërlidhja e fushave ndërhyrëse	Institucionet përgjegjëse
A. Menaxhimi i Pyjeve, Silvikultura (Shtylla I)	A.1 Zhvillimi i kapaciteteve	Ngritja e kompetencave në menaxhimin e pyjeve ka krijuar pyje më produktive dhe më me vlerë	D.3	IHP
	A.2 Menaxhimi i grumbujve të rinj pyjorë	Ngritje e prodhimit të drurit përmes pyllëzimeve të tokave të zhveshura apo të tokave pyjore të pashfrytëzuara	B.2	IHP, APK
	A.3 Monitorimi i shëndetit të pyjeve	Zvogëlim i rreziqeve nga dëmtuesit dhe sëmundjet	B.1, B.2	
	A.4 Përkujdesja për pyjet e reja	Ngritje e prodhimit nga pyjet me vlera të larta pyjore	B.2, F.4, B.1	
B. Planifikimi pyjor (Shtylla II)	B.1 Inventarizimi i pyjeve	Vendimet strategjike/politike janë të bazuara në informacione të sakta	E.2, E.3	APK
	B.2 Planifikimi i menaxhimit pyjor	Selektimi dhe trajtimi i grumbujve pyjorë është i bazuar në informacione relevante	E.2, E.3	
	B.3 Planifikimi i operacioneve	Planifikimi i përmirësuar ka zvogëluar dëmtimet e pyjeve dhe ka kontribuar në një treg më transparent dhe më stabil të drurit	D.1, D.2	
C. Shfrytëzimi & transporti (Shtylla II)	C.1 Shfrytëzimi i paligjshëm	Shkalla e shfrytëzimit të paligjshëm është zvogëluar, ndërsa të hyrat për buxhetin fiskal të shtetit janë rritur	B.3, F.1, H.1	MBPZHR, APK, DP
	C.2 Rishikim i nevojave për kontroll	Marrëveshjet me Shoqata të Pronarëve të Pyjeve rezultojnë në zvogëlimin e punës monitoruese për shfrytëzim dhe transport	F.2	
	C.3 Praktikant shfrytëzues	Metodat e përmirësuara të kombinuara me planifikim të mirë rezultojnë në zvogëlim të dëmeve në pyje dhe toka pyjore	B.3	
D. Ndërtimi i kapaciteteve (Shtylla I)	D.1 Arsimi profesional për pylltari	Një shkollë e mesme profesionale për pylltari është në funksion	F.2, F.3, F.4	MASHT, MBPZHR, MPMS
	D.2 Trajnime profesionale për pylltari	Qendra trajnuese, e organizuar për të operuar në gjithë Kosovën, rrit shkathësitë e punëtorëve pyjor	F.2, F.3, F.4	
	D.3 Arsimimi i lartë për pylltari	Organizim i arsimimit të lartë për studentë në Kosovë apo në fakultete jashtë vendit	A.1, E.1	
	D.4 Ngritje e vetëdijes	Publiku është i vetëdijshëm për rolin e pyjeve si një element i rëndësishëm i shoqërisë dhe si ofrues i përfitimeve të llojllojshme	E.1	
E. Mbrojtje e mjedisve pyjore (Shtylla I)	E.1 Zhvillimi i kapaciteteve	Kapacitete të përmirësuara për t'u marr me çështje mjedisore lidhur me pylltarinë, konsensus lidhur me nevojat për mbrojtje/shfrytëzim të tokave	A.1, G.1	MMPH, MBPZHR
	E.2 Plan i veprimit për biodiversitet	Institucionet e Kosovës kanë kapacitete që të zbatojnë dhe monitorojnë planin e veprimit për biodiversitet	B.1, B.2	
	E.3 Shpallja e zonave të mbrojtura	Zonat e mbrojtura janë shpallur në përputhje me qëllimet nacionale dhe marrëveshjet ndërkombëtare	B.1, B.2	
F. Zhvillimi i sektorit privat, Shfrytëzimi i drurit (Shtylla I)	F.1 Privatizimi i NSH	Strukturat e vjetra të NSH janë ndërruar me ato të reja, të cilat kanë kapacitete që t'u përshtaten kushteve të tregut të hapur		MBPZHR, AKP
	F.2 Mbështetje për SH. e Pronarëve të Pyjeve	Pronarë të pyjeve private janë të përfaqësuar në bërjen e politikave, prodhimi dhe të hyrat janë përmirësuar	D.1, D.2	MBPZHR, MASHT
	F.3 Trajnime për ndërmarrësi	Afaristët janë në gjendje të zhvillojnë operacione efektive dhe në përshtatje me mjedisin	D.1, D.2	
	F.4 Përpunimi i drurit	Janë krijuar industri për përpunim të trupave me madhësi të vogël dhe ofrim i mundësive për punësim në zonat rurale	F.2	MTI, MEF
	F.5 Prodhimi i bio energjisë	Biomasa e drurit për ngrohje është prodhuar dhe shfrytëzuar në mënyrë më efektive	F.4	
	F.6 Konsolidimi i tokave	Pronësi më e madhe private dhe me një konfiguracion që rrit vlerat dhe lehtëson menaxhimin	H.1, H.2	MBPZHR, AK.
G. Produkte jodrusore (Shtylla I)	G.1 Hartimi i legjislacionit	Një ligj që rregullon grumbullimin dhe përpunimin e bimëve mjekësore dhe aromatike është hartuar	A.1	Njësi për hartim të ligjeve
	G.2 Produktet pyjore jodrusore	Potenciali për produkte pyjore jodrusore, përfshirë turizmin, janë analizuar dhe ofrojnë baza për zhvillim të mëtejshëm	B.1	MMPH, MTI, MBPZHR
H. Mbështetje për institucionet dhe organizatat (Shtylla III)	H.1 Plani i Veprimit	Kapacitetet e Qeverisë për të zbatuar dhe monitoruar politikën dhe strategjitë janë përmirësuar	Siç kërkohet	MBPZHR, MEF
	H.2 Mbështetje institucionale dhe teknike	Kapacitetet e institucioneve dhe organizatave për të zgjidhur dhe për të shqyrtuar zbrastësitat institucionale janë përmirësuar		

MBPZHR: Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural  
MASHT: Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë  
MMPH: Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor  
MPMS: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale  
AK: Agjencia Kadastrale  
MEF: Ministria e Ekonomisë dhe Financave

MTI: Ministria e Tregtisë dhe Industrisë  
AKP: Agjencia Kosovare e Privatizimit  
IHP: Instituti për Hulumtime Pyjore  
APK: Agjencia Pyjore e Kosovës  
DP: Departamenti i Pylltarisë

#### **4.6 Rreziqet e përfshira, veprimet që mund të zvogëlojnë efektin**

Rreziqet kryesore që mund të pengojnë apo pamundësojnë zbatimin e suksesshëm të strategjisë janë të lidhura me faktorët, si: (i) mungesa e mbështetjes së plotë nga ana e autoriteteve vendimmarrëse, ndryshimi i prioriteteve qeveritare; (ii) koordinim i dobët gjatë zbatimit të projekteve; (iii) kapacitete të zbehta absorbimi; (iv) interesim i pakët prej donatorëve dhe (v) mungesë e vijave kreditore për mbështetje të investimeve. Të gjithë këta faktorë janë në masë të madhe të ndërlidhur mes vete.

##### Prioritetet qeveritare dhe mbështetja

Sipas ekspertëve pyjorë, pylltaria dhe çështjet e saj duhet të jenë shumë më lart në agjendën e Qeverisë dhe që pylltaria duhet të jetë një ndër sektorët me më prioritet. Rëndësia e pyjeve të shëndosha dhe i sektorit të industrisë pyjore mund të arsyetohet lehtë me faktin që sektori pyjor është një ofruer i rëndësishëm i mundësive të punësimit dhe që mundet në mënyrë qenësore të kontribuojë në stabilitet dhe përmirësim të sigurisë. Në mënyrë që të ketë një efekt sa më të mirë nga aktiviteti i projekteve dhe të zvogëlohet rreziku prej mosmarrëveshjeve, është me rëndësi vitale që të njihet rëndësia e mëtejshme e sektorit prej lidhshimit politik, dhe që pastaj do të ofrojë fuqi vendimmarrëse direkte apo indirekte.

##### Koordinim i dobët në zbatimin e projekteve

Nevoja për një koordinim të fuqishëm të përpjekjeve zhvillimore është theksuar disa herë më parë. Deri tani zhvillimi i pylltarisë në Kosovë ka qenë i koordinuar relativisht mirë, duke filluar prej krijimit të institucioneve, hartimit të legjislacionit, vlerësimit të resurseve pyjore, ndërtimit të kapaciteteve, mbështetjes së vazhdueshme për institucionet etj. Zbatimi i programeve, projekteve etj., do të jetë fillimi i një zhvillimi të ri, i cili është suksesiv dhe i cili do të jetë në përputhje me politikat dhe strategjitë e miratuara, por edhe me të arriturat e mëparshme dhe përvojat e nxjerra.

Faktorët e rrezikut shtrihen edhe në kapacitetet për të marrë përsipër një paketë zhvillimore kaq komplekse që do të ekzekutohet gjatë një periudhe të gjatë kohore. Për të zvogëluar rrezikun e mosarritjes complete dhe dështimeve për shkak të faktorëve të ndryshëm, dhe si plotësim për mirëmbajtje të Bordit Menaxhues, stafi ministror në pozita kyçe duhet të ketë qëndrime, kompetencë teknike dhe stil të punës që ka prioritet zhvillimin e mirëfilltë pyjor. Ekspertët duhet të jenë në dispozicion që të punojnë ngushtë me këshilltarët teknikë, aty duhet të ketë vullnet për diskutim dhe testim të koncepteve të reja që janë të lidhura me pronësinë, menaxhimin, disponueshmërinë e informacioneve, etj.

Kapacitetet absorbuese

Numri i ekspertëve vendorë, të cilët janë të arsimuar dhe të motivuar për t'u angazhuar në çështje zhvillimore është ende i kufizuar. Veç kësaj, këta ekspertë janë të obliguar që së pari të plotësojnë detyrat që kërkohen nga lidhshipi i ministrisë (gjë që është logjike). Por kjo lë të kuptohet se mosdhënia me kohë e inputeve për projekte është pengesë që rezulton në kapacitete të ndërtimit dhe pronësi jooptimale vendore. Deri tani këtu ka qenë një rotacion relativisht i lartë i ekspertëve, gjë e cila ka dërguar në humbje të kohës dhe të momentit. Veç kësaj ka shembuj ku ekspertë me përvojë kanë ndryshuar pozitën dhe kjo ka ndikuar në punën e projektit (por natyrisht ka forcuar pjesët e tjera të sektorit).

Nuk ka zgjidhje të lehtë për këto probleme, ekzistojnë edhe rreziqe të ndërlidhura. Mundësitë për mbështetje financiare janë të kufizuara. Zgjidhja më e mirë është që gjithmonë të identifikohen personat që kanë përkushtim të madh ndaj detyrave dhe vullnet për të marrë pjesë në procesin e ndryshimeve, si dhe të mirëmbahet një mjedis stimulativ i punës.

Përkushtimet e donatorëve

Faktorët si stabiliteti politik, planet zhvillimore koordinuese dhe konsistente, përkushtimi i palëve të interesit, rotacioni i ulët i stafit, vullneti për të bërë të mundshme shërbimet dhe mbështetjen e personave kyçë, kryerja efikase dhe e shpejtë e çështjeve administrative, etj., janë faktorë crucialë. Nëse këto lloje të çështjeve mirëmbahen mirë, procesi i vendimit nga ana e donatorëve do të jetë më lehtësues dhe shumë më i shkurtër, gjë që do të rezultojë në zbatimin e shpejtë të projekteve. Bashkëpunimi i mirë mes donatorit dhe pranuesit gjithashtu do të zvogëlojë rreziqet për ndërprerje apo shtyrje të punëve që shumë shpesh dërgon në humbje të hapit për proceset zhvillimore.

Mungesa e vijave kreditore për të mbështetur investimet

Një ambicie është që të identifikohen mundësitë për zbatim të investimeve (fusha ndërhyrëse F), për t'ju ofruar investitorëve privat. Realizimi i investimeve, në shumicën e rasteve, do të kërkojë mbështetje prej burimeve të jashtme financiare. Për këtë arsye dhe që të zvogëlohet rreziku për humbjen e mundësive të investimeve, një komponent që do të merret me çështjet financiare duhet të jetë pjesë integrale e zhvillimit të sektorit privat.